

UDHËZIM
Nr.1, datë 6.1.2012

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 84 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, me propozim të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, me vendimin nr.17, datë 17.10.2011,

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet në Autoritetin Portual Durrës, caktohen sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i tarifës për shërbimet është shprehur pa TVSH.

2. Institucioni përgjegjës për vjeljen e tarifave është Autoritetit Portual Durrës ose subjekte të autorizuar prej tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën 20.1.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare në numrin më të parë të radhës.

Udhëzimi nr.122, datë 26.1.2011 shfuqizohet.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Sokol Olldashi